



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 47

Tiranë – E martë, 9 prill 2019

## PËRMBAJTJA

|                                                                                    | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 44/2019, datë 3.4.2019                                    | Për emërimin e zotit Deniz Deralla anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare..... 3749                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 45/2019, datë 3.4.2019                                    | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 102/2017, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore”, të ndryshuar..... 3749                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Rezolutë e Kuvendit<br>datë 3.4.2019                                               | Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018..... 3749                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Rezolutë e Kuvendit<br>datë 3.4.2019                                               | Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2018..... 3750                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Dekret i Presidentit<br>nr.11156, datë 29.3.2019                                   | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3752                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 11157, datë 1.4.2019                                   | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3753                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë<br>dhe Zhvillimit Rural nr. 231,<br>datë 29.3.2019 | Për ndalimin e peshkimit në liqenin e Shkodrës..... 3753                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Vendim i Entit Rregullator<br>të Energjisë nr. 48, datë 27.3.2019                  | Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “S.P.E Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gjadër nr. 1/1”, me kapacitet të instaluar 2134 kw, HEC “Gjadër nr. 1/2” me kapacitet të instaluar 4406 kw, HEC “Gjadër nr. 2”, me kapacitet të instaluar 2983 kw, HEC “Gjadër nr. 3”, me kapacitet të instaluar 3874 kw, HEC “Gjadër nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 kw, HEC “Gjadër nr. 6”, me kapacitet të instaluar 5619 kw, me kapacitet total të instaluar 24.938 kw..... 3754 |

|                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                              |      |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 49, datë 27.3.2019                                                                     | Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, të lidhur ndërmjet shoqërisë ALBGAS sh.a. dhe shoqërisë ALBPETROL sh.a. për vitin 2019....                                                                | 3755 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 50, datë 27.3.2019                                                                     | Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2mw, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier..... | 3757 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 7, datë 8.2.2019   | Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës-kanalizime Gjirokastër sh.a. ....                                                                                                      | 3758 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 8, datë 8.2.2019   | Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës-kanalizime Poliçan sh.a. ....                                                                                                          | 3763 |
| Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 11, datë 27.2.2019 | Për licencimin e shoqërisë ujësjellës-kanalizime Pukë sh.a.....                                                                                                                                                                                              | 3768 |
| Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 125, datë 4.4.2019                                                                   | Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....                                                  | 3770 |
| Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 4767, datë 2.4.2019                                                       | Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje me Gjermaninë.....                                                                                                                                                                                                   | 3772 |
| Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3670/2, datë 29.3.2019                                                   | Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike, Lushnje” .....                                                                                               | 3772 |
|                                                                                                                                    | Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Gazmir Bala.....                                                                                                                                                                                                | 3774 |
|                                                                                                                                    | Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Florenc Bane.....                                                                                                                                                                                               | 3774 |



**VENDIM**  
**Nr. 44/2019**

**PËR EMËRIMIN E ZOTIT**  
**DENIZ DERALLA ANËTAR I BORDIT**  
**TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES**  
**FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 111, pika 3, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 6, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zotit Deniz Deralla emërohet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas propozimit të Bankës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
**Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 3.4.2019.

**VENDIM**  
**Nr. 45/2019**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME**  
**NË VENDIMIN E KUVENDIT**  
**NR. 102/2017, “PËR NGRITJEN**  
**E KOMISIONIT TË POSAÇËM**  
**PARLAMENTAR PËR REALIZIMIN**  
**E REFORMËS ZGJEDHORE”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 102/2017, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për

Realizimin e Reformës Zgjedhore”, të ndryshuar”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën V bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Damian Gjiknuri (PS) caktohet bashkëkryetar në vend të deputetes Blerina Gjylameti.

II. Deputetja Blerina Gjylameti (PS) caktohet anëtare.

2. Pas pikës IX shtohet pika IX/1 me këtë përmbajtje:

“IX/1. Pranë Komisionit caktohet, në cilësinë e vëzhguesit, përfaqësuesi i partisë më të madhe të opozitës (PD), sipas rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, i cili gëzon të drejtat e plota të përcaktuara në pikën VIII, si dhe ato të pikës IX, të këtij vendimi që u përkasin bashkëkryetarëve të Komisionit.”.

3. Afati i veprimtarisë së Komisionit zgjatet deri në datën 5 maj 2019.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
**Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 3.4.2019.

**REZOLUTË**  
**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË**  
**AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**  
**PËR VITIN 2018**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

- Duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar;

- Duke njohur bashkëpunimin e këtij Autoriteti me institucionet qendrore e ato rregullatore për aktet që mund të prekin funksionimin e konkurrencës në tregje;

- Duke konsideruar se mirëfunksionimi i tregjeve kërkon gjithëpërfshirjen e aktorëve dhe faktorëve të tregut, për t'i bërë ata konkurrues dhe sa më të hapur, me synim mirëqenien e konsumatorit;

**Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2018 në drejtim të:**

- Rritjes së nivelit të bashkëpunimit me organet e administratës shtetërore dhe lidhjes së marrëveshjeve të reja me entet rregullatore, në



ruajtje të mjedisit konkurrues dhe vendosjes së balancave ekonomike.

- Shtimit të numrit të hetimeve në tregjet tradicionale dhe veçanërisht në tregjet e reja shumë sensitive për publikun e gjerë.

- Monitorimit në vazhdimësi të zbatimit të rekomandimeve, dhënë nga Komisioni i Konkurrencës, organeve të administratës shtetërore dhe enteve rregullatore, sipas tregjeve që ato rregullojnë.

- Realizimit të ekzekutimit të vendimeve të marra nga Komisioni i Konkurrencës gjatë vitit 2018, si dhe vendimeve të marra në vite.

- Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe përmirësimit të nivelit të ekspertizës së stafit për t'iu përshtatur dinamikës së tregjeve në zhvillim.

- Plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ, në kuadër të përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë evropian në fushën e konkurrencës, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2018-2020.

**Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës, për vitin 2019, të përmirësojë punën në këto drejtime:**

- Të monitorojë përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në tregjet e hetuara gjatë vitit 2018 e veçanërisht për kontratat koncesionare në fuqi, të cilat sjellin deformime të konkurrencës në treg, duke evidentuar dhe përlogaritur dëmin apo përfitimin real të konsumatorit publik.

- Të mbikëqyrë me prioritet dhe të dalë me rekomandime konkrete për tregjet me sensitivitet të lartë publik e ndikim social si: tregu bankar, tregu i shërbimeve spitalore dhe tregu farmaceutik, si dhe sektori i arsimit të lartë publik dhe privat.

- Të nisë rishikimin e ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, me fokus përputhshmërinë e plotë me legjislacionin e BE-së në fushën e konkurrencës, në kuadër të përgatitjes për anëtarësim në Bashkimin Evropian, përshtatur me kushtet e reja të zhvillimit ekonomik të vendit tonë.

- Të kontribuojë në sensibilizimin e mëtejshëm të publikut për rolin e Autoritetit në garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe njohjen më të saktë të publikut me fushën e veprimtarisë së Autoritetit.

- Të vijojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Integritimit Evropian (PKIE) në drejtim të përafrimit të legjislacionit me direktivat europiane në fushën e konkurrencës.

- Të përqendrohet në trajnimin e stafit të AK-së në lidhje me vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta dhe sidomos në vlerësimin e procedurave të prokurimit publik për marrëveshjet e ndaluara në oferta.

- Të jetë më proaktiv në vlerësimin ex-ante të projektligjeve, si dhe të njoftojë Kuvendin për vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës në lidhje me çdo akt ligjor që prek parametrat e konkurrencës, në fazën e shqyrtimit të tyre nga komisionet parlamentare përgjegjëse.

**Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:**

- Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektakt normativ që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe, veçanërisht, për kontratat koncesionare.

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Miraturar në datën 3.4.2019

KRYETARI  
Gramoz Ruçi

**REZOLUTË  
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË  
SË KOMISIONIT QENDROR TË  
ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2018**

Pas shqyrtimit të raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtarinë e vitit 2018 dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Problematikat e hasura në zgjedhjet e kaluara për Kuvendin dhe efektet që prodhuan vonesat e regjistrimit të subjekteve zgjedhore, listave të kandidatëve dhe të tjera të lidhura me afatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor;

- Problematikat lidhur me procedurat e ndjekura nga KQZ-ja lidhur me shqyrtimin e



pasqyrave financiare dhe kontrollin e financave, financimeve dhe raportimeve të lidhura me to nga partitë politike;

- Problematikat e vazhdueshme të konstatuara gjatë mbikëqyrjeve të listave të zgjedhësve;

- Problematikat e zëvendësimit të vendeve të mbetura bosh, për shkak të dorëheqjeve nga mandatet, apo vullnetit për mosmarrjen e mandatit, sipas procedurave të Kodit Zgjedhor, nga kandidatët pasues në listat shumëmemërore;

dhe

- Duke vlerësuar daljet publike të Kryetarit të KQZ-së, si dhe përfaqësuesve të KQZ-së për tërheqje të vëmendjes dhe sensibilizim të subjekteve zgjedhore, nëpërmjet njoftimeve publike dhe kujtesave për respektim të afateve dhe kushteve të parashikuara nga Kodi Zgjedhor për regjistrim dhe dorëzim dokumentacioni pranë KQZ-së;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

- Gjatë vitit 2018 janë konstatuar probleme në lidhje me plotësimin e kërkesave dhe detyrave të lëna nga Kuvendi, me rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2018 e që përfshiheshin në fushën e veprimtarisë dhe kompetencën e KQZ-së, për shkak të bllokimit të procesit të miratimit të Kodit të ri Zgjedhor, për shkak të mungesës së vullnetit të anëtarëve të caktuar të KQZ-së, apo për shkak të mungesës së bashkëpunimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- Për shkak të bojkotit të deklaruar nga subjekte politike që kanë qenë historikisht subjekte zgjedhore, mund të vlerësohet se KQZ-ja gjatë vitit 2019 mund të ndodhet në situata të ngjashme me ato në të cilat u vu gjatë periudhës parazgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2017.

Kuvendi i Shqipërisë, për sa më sipër, duke konsideruar faktin që viti në vazhdim është vit zgjedhor, përveç mbështetjes institucionale që i duhet ofruar në vijim Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që gjatë vitit 2019, përveç kryerjes së detyrave funksionale, të parashikuara nga Kodi Zgjedhor, të fokusohet edhe në këto drejtime:

- Të miratojë, në përputhje me Manualin e Raportimit Vjetor dhe Periodik, programin e punës për vitin në vazhdim;

- Të marrë masa për garantimin e funksionimit të rregullt të administratës zgjedhore, duke konsideruar që mund të ndodhet në kushtet e braktisjes së sistemit nga partitë kryesore të opozitës parlamentare;

- Të marrë masa të përshtatshme dhe proporcionale për monitorimin nga afër të kushteve dhe kritereve ligjore për financimin publik e privat të fushatës zgjedhore të subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje;

- Të hartojë metodologjitë e kontrollit dhe verifikimit të shpenzimeve të financimeve të partive politike dhe fushatave elektorale, brenda dhe jashtë vendit, duke shqyrtuar edhe mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse që kontrollojnë pastrimin e parave dhe financimet e kundërligjshme. Të përmirësojë shqyrtimin administrativ të verifikimit të financimeve të fushatave zgjedhore jo vetëm mbi bazën e deklarimeve të subjekteve zgjedhore, por edhe mbi bazën e dokumenteve dhe fakteve të deklaruara apo të bëra publike, duke referuar në eksperiencat e vitit 2018;

- Të ngrejë mekanizmat e monitorimit të fushatës në media, të sigurojë transparencën e rregullave të monitorimit të mediave, të reagojë në kohë dhe t'u kundërpërgjigjet me masa të shpejta, proporcionale dhe efikase praktikave që prishin barazinë ligjore të fushatës mediatike;

- Të përpunojë strategjitë e përshtatshme të edukimit zgjedhor në përgjigje të rrethanave specifike politike;

- Të lehtësojë procedurat për akreditimin e vëzhguesve, me qëllim rritjen e transparencës së procesit zgjedhor dhe mbulimin kapilar të tij;

- Të marrë masa të përshtatshme dhe proporcionale për monitorimin nga afër të përdorimit të burimeve shtetërore dhe të ndërhyjë në kohë reale pranë institucioneve publike për ndërprerjen dhe korrigjimin e praktikave të kundërligjshme në këtë drejtim;

- Në rast të masave ndëshkimore me gjobë, ndaj subjekteve zgjedhore, për shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, të nisin menjëherë procedurat e mbledhjes së detyrimeve financiare;

- Të synojë në një sjellje institucionale për sa i takon vendimmarrjes, në funksion të ruajtjes së pavarësisë dhe referim në dispozitat ligjore, në plotësim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e



integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të sigurojë në të ardhmen interpretimin dhe zbatimin me paanësi dhe të njëjtë të ligjit;

- Në funksion të transparencës dhe sigurimit të aksesit të publikut në informacionin e bërë publik në faqen zyrtare të KQZ-së, të rishikohet adresa identifikuese e KQZ-së. Kjo adresë duhet të konsiderojë gjuhën e përdorur nga publiku (shqip), fjalët kyçe të përdorshme për identifikimin automatik dhe logjikën e navigimit në internet nga perspektiva e publikut të thjeshtë dhe jo atij të specializuar e që e njeh mirë Komisionin dhe organizimin e faqes zyrtare të tij;

- Të miratojë rregullat e përfaqësimit në publik të institucionit dhe të daljeve publike të anëtarëve të KQZ-së, në përputhje me Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik, të miratuar me vendim Kuvendi. E gjithë sjellja dhe veprimtaria e tyre duhet të përshtaten me funksionin publik, me qëllim që të sigurohet dhe të mos cenohet paanësia në ushtrimin e funksionit individual, nga njëra anë, dhe funksionit të institucionit, nga ana tjetër, duke evituar shprehjet e mendimit personal, jashtë tryezës së mbledhjes së KQZ-së;

- KQZ-ja të vlerësojë hapësirat, brenda të cilave mund të ndikojë në rritjen e pjesëmarrjes dhe sensibilizimin për këtë qëllim të pakicave dhe minoriteteve.

Miratuar në datën 3.4.2019.

**KRYETARI**  
**Gramoz Ruçi**

**DEKRET**  
**Nr. 11156, datë 29.3.2019**

### **PËR DHËNIE TË SHTETËSISË** **SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me porpozim edhe të Ministrisë së Brendshme

### **DEKRETOJ:**

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, pesonave të mëposhtëm:

1. Davut Ibrahim Erdinç Erol
2. Taibe Musa Belegu (Gjakova)
3. Selman Shaban Hajdari
4. Foto Mitro Ciko
5. Serdar Recep Sertçelik
6. Tuğçe Arif Işidan Sertçelik (Işidan)
7. Mileta Vuksan Dašić (Dashiq/Dashiç)
8. Naser Hysen Samadraxha
9. Xhafer Fazli Zenunaj
10. Mara Flaviano Olivani
11. Maria Isabel Fidel Aguilar Melchor
12. Emma Jayne Ernest Charles Keith Hysa (Baker)
13. Michaela Jan Kubičková
14. Segun James Olubayo Adeniyi
15. Vexhi Nuhi Rushidi
16. Fulvio Rodolfo Misasi
17. Hafide Remzi Xhika (Guri)
18. Avni Ali (Alija) Mehmeti
19. Rifat Azem Thaçi
20. Florina Xhafer Shehu (Lila)
21. Gianfranco Vittorio Mauro
22. Ardian Ramadan Aliu
23. Latif Arif Ibrahim
24. Natalia Igor Ivanova (Demchenko /Demçenko)
25. Hasan Süleyman Samraoğlu
26. Yigit Fahrettin Amir Arman
27. Abdulhadi Samir Darwish Taleb
28. Leonard Samedin Topalli
29. Giuseppe Nicola Franccone
30. Fazli Rexhë Zenunaj
31. Terezinha Severino Camargo Soares
32. Agim Dervish Dalipi
33. Ahmad Mohamad Karmid
34. Tasnim Ahmad Karmid
35. Youni Ahmad Karmid
36. Egzona Imri Dragjoshi (Ferati)
37. Luca Alvaro Falanga
38. Rinor Bektesh Rudhani
39. Leonard Isa Haskaj
40. Veton Agim Podujeva
41. Aateqa Salma Naseer Ahmed Khan
42. Ilire Selim Bunjaku Thaqi (Thaqi)



43. Vera Simon Preqi
44. Vlora Zeqir Hamitaj (Kelmendi)
45. Veton Nuhi Tulla
46. Arif Rifat Azemi
47. Annelize Abraham Johannes Levendi (Ras)
48. Taulant Ilir Gashi
49. Ali Serdar Süleyman Sirri Pedükcoşkun
50. Tringa Teki Guxho (Shehu)
51. Zana Rustem Gashi (Gjocaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Ilir Meta**

**DEKRET**  
**Nr. 11157, datë 1.4.2019**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË  
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Elton Sefulla Mersini
2. Dorina Petrit Shehi
3. Xheni Rebi Tufa
4. Bashkime Isuf Mulgeci (Nokshiqi)
5. Alma Iljaz Mulgeci
6. Alban Iljaz Mulgeci
7. Ingrid Dashamir Babani
8. Suzana Sami Canja (Cani)
9. Endri Lutfi Derveni
10. Stela Mersin Pushaj (Haxhiaj)
11. Elton Fatbardh Hushi
12. Xhana Hyjnor Kalamishi
13. Samuel Gjovalin Picaku
14. Ekaterini (Aikaterini) Arqile Mone

15. Rudina Ram Gabraj (Hoxhaj)
16. Klevis Shkelzen Gabraj
17. Adrian Xhavit Zguri
18. Elvis Gani Sallmone
19. Enkelejda Dhimitër Bargio
20. Fjona Kujtim Shtjefni (Ahmeti)
21. Angela Gjergj Shtjefni
22. Xhenifer Kujtim Maloku (Uka)
23. Jeta Ramazan Maloku (Langguth)
24. Iva Petraq Simo
25. Erion Xhevahir Faruku
26. Dardan Granit Leka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Ilir Meta**

**URDHËR**  
**Nr. 231, datë 29.3.2019**

**PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË  
LIQENIN E SHKODRËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, si dhe të pikës 2, të nenit 4, të rregullores nr. 1, datë 7.3.2014 “Për zbatimin e ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin””, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdo lloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhjen në treg ose për konsum i të gjitha llojeve të peshqve në liqenin e Shkodrës, nga data 1.4.2019 deri më 30.4.2019.

2. Për periudhën 1.5.2019-30.6.2019, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën breg/liqenore prej 250 ml nga bregu.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në zonat e përcaktuara nga OMP-ja.



4. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një plan i përbashkët operativ veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me OMP-në e këtij liqeni.

5. OMP-ja të marrë të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqenin e Shkodrës.

6. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategji të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në vartësi të së cilës është Sektori i Monitorimit dhe Kontrollit të Peshkimit, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës, që të monitorojnë zbatimin e Planit Operativ të Veprimit për zbatimin e këtij urdhri, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore Shkodër e Malësi e Madhe, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në Qarkun e Shkodrës si dhe me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) të qarkut Shkodër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Bledar Çuçi**

**VENDIM**  
**Nr. 48, datë 27.3.2019**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPE  
GJADËR” SHPK, NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HEC-et “GJADËR  
NR. 1/1”, ME KAPACITET TË  
INSTALUAR 2134 kw, HEC “GJADËR NR.  
1/2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR  
4406 kw, HEC “GJADËR NR. 2”, ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 2983 kw,  
HEC “GJADËR NR. 3”, ME KAPACITET  
TË INSTALUAR 3874 kw, HEC “GJADËR  
NR. 4”, ME KAPACITET TË INSTALUAR  
5922 kw, HEC “GJADËR NR. 6”, ME  
KAPACITET TË INSTALUAR 5619 kw, ME  
KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR  
24.938 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e  
Faqe | 3754

energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.3.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SPE Gjadër” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SPE Gjadër” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 195 prot., datë 28.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “SPE Gjadër” sh.p.k. është krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, në zbatim të detyrimit të nenit 8, të kontratës së koncensionit të formës “BOT”, nr. 10328 rep. dhe nr. 322 kol., datë 9.9.2013, të lidhur midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, me cilësinë e Autoritetit Kontraktues, dhe bashkimit të shoqërive “Ani” sh.p.k., “Rafaelo 2002” sh.a., “Junik” sh.p.k., “Vllaznimi” sh.p.k., “SPE Energy” sh.p.k., “EUES Energy” sh.p.k., për një afat 35-vjeçar nga hyrja në fuqi, ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit të lidhur midis MIE dhe “SPE Gjadër” sh.p.k., me nr. 328 rep. dhe nr. 176 kol., datë 17.6.2015, “Për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve, në lumin Gjadër”.

Aplikimi i shoqërisë “SPE Gjadër” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;



- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2; pika 4.1.3, germa “a”, “b”, “d”, pika 4.1.4, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, pika 4.1.5, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca), germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti);

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- Dokumentacioni teknik dhe grafik, neni 9, pika 4.1.3, germa “c” do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë atë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPE Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Gjadër nr.1/1”, me kapacitet të instaluar 2134 kV, “HEC Gjadër nr.1/2”, me kapacitet të instaluar 4406 Kw, “HEC Gjadër nr. 2” me kapacitet të instaluar 2983 Kw, “HEC Gjadër nr. 3” me kapacitet të instaluar 3874 k Kw, “HEC Gjadër nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 Kw, “HEC Gjadër nr. 6”, me kapacitet të instaluar

5619 Kw, me kapacitet total të instaluar 24.938 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM  
ANËTARE E BORDIT  
Erjola Sadushi

#### VENDIM Nr. 49, datë 27.3.2019

#### **MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR SHËRBIMIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR, TË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRISË ALBGAS SHA DHE SHOQËRISË ALBPETROL SHA PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 35 dhe nenit 36 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016 “Për krijimin e shoqërisë ALBGAS sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive: ALBGAS sh.a. dhe ALBPETROL sh.a.”, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit funksionit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 27.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për miratimin e kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, të lidhur ndërmjet shoqërisë ALBGAS sh.a. dhe shoqërisë ALBPETROL sh.a., për vitin 2019, konstatoi se:

- Shoqëria ALBGAS sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 222 prot., datë 13.3.2019, ka kërkuar miratimin e kontratës me nr. 1026 prot., datë 4.2.2019 i ALBPETROL sh.a., dhe nr. 25



prot., datë 25.2.2019 i ALBGAS sh.a., të lidhur ndërmjet shoqërisë ALBPETROL sh.a. dhe ALBGAS sh.a., për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, për një afat njëvjeçar duke filluar nga data 1.1.2019 - 31.12.2019.

- Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016 për “Për krijimin e shoqërisë ALBGAS sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive: ALBGAS sh.a. dhe ALBPETROL sh.a., shoqëria ALBGAS sh.a., ushtron aktivitetin si operator i kombinuar i sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri.

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, shoqëria ALBGAS sh.a. është certifikuar si operator i kombinuar i gazit natyror, si dhe me vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2018, është licencuar në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar.

- Shoqëria ALBGAS sh.a. është licencuar në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, për një afat 30-vjeçar.

- Shoqëria ALBPETROL sh.a. kryen aktivitetin e prodhimit dhe shitjes së gazit natyror, ndërsa shoqëria ALBGAS sh.a., realizon transmetimin e gazit natyror me anë të linjave të veta. Kjo kontratë rregullon çmimin, kushtet dhe afatet për realizimin e këtij bashkëpunimi midis prodhuesit dhe operatorit të transmetimit të gazit natyror.

- Shoqëria ALBGAS sh.a. funksionon si operator i kombinuar i gazit natyror dhe ka depozituar në ERE kontratën e lidhur ndërmjet shoqërisë ALBPETROL sh.a. dhe shoqërisë ALBGAS sh.a. Kjo kontratë gjen mbështetje në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9901, datë 1.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, në ligjin nr. 7582, datë 3.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin transportimin dhe tregtimin e naftës dhe gazit natyror dhe nën produkteve të tyre”, të ndryshuar, në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, në vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAS sh.a., për vitin 2018”.

- Objekti i kontratës midis ALBGAS sh.a. dhe ALBPETROL sh.a. është transmetimi i gazit natyror nga shoqëria ALBGAS sh.a., kundrejt një tarife transmetimi për llogari të shoqërisë ALBPETROL sh.a.

- Çmimi i ofrimit të shërbimit të transmetimit të gazit natyror sipas kësaj kontrate është ai i vendosur në bazë të vendimit të bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAS sh.a., për vitin 2018”, lënë në fuqi me vendimin e bordit të ERE-s nr. 269, datë 21.12.2018, deri më 31 mars 2019, për tarifën e shërbimit të transmetimit është 28 lekë/m<sup>3</sup>, pa TVSH, ku shoqëria ALBGAS sh.a., është me cilësinë e transmetuesit të gazit natyror dhe shoqëria ALBPETROL sh.a., është me cilësinë e prodhuesit të gazit natyror.

- Në lidhje me këtë përcaktim të kontratës sqarojmë se, pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 269, datë 21.12.2018, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAS sh.a. për vitin 2018, i ndryshuar, siguron që, në rast se tarifa e miratuar për periudhën mbas datës 31 mars 2019 deri më 31 dhjetor 2019 rezulton e ndryshme nga ajo e përkohshme (28 lekë/m<sup>3</sup>), atëherë efektet e mundshme në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë ALBGAS sh.a., do të përditësohen dhe kompensohen sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

- Duke qenë se çmimi që do të aplikohet për këtë kontratë do të jetë ai që do të miratojë bordi i ERE-s për vitin 2019, ERE i është drejtuar shoqërisë ALBGAS sh.a. me shkresën nr. 206 prot., datë 7.3.2019, ku i ka kërkuar këtij të fundit paraqitjen sa më shpejtë të të ardhurave të kërkuara për të mundësuar zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërisë ALBGAS sh.a. për vitin 2019 ose ndjeshmërinë/pritshmërinë e shoqërisë, në lidhje me mjaftueshmërinë e tarifës në fuqi të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018, për të cilën është ende në pritje të përgjigjes.

- Sasia e gazit për t'u transmetuar është planifikuar ndjeshëm më e ulët nga sa pranuar në llogaritjen e tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2018. Një rënie e tillë në rast se të ardhurat



e kërkuar për vitin 2019 do t'i konsideronim të pandryshuara, do të rezultonte në një rritje të tarifës së transmetimit. Në lidhje me këtë parashikim, nisur dhe nga shkresa e sipërcituar e ERE-s, ku i kërkohej shoqërisë të shprehet mbi mjaftueshmërinë e tarifës në fuqi, në vijim do të vazhdohet komunikimi ndër të tjera edhe për këtë element të rëndësishëm të llogaritjes së tarifës së transmetimit të gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror të lidhur ndërmjet shoqërisë ALBGAS sh.a. dhe shoqërisë ALBPETROL sh.a., për vitin 2019.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM,  
ANËTARE E BORDIT  
Erjola Sadushi

#### VENDIM

Nr. 50, datë 27.3.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART  
WATT” SHPK, NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA CENTRALI  
FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË  
INSTALUAR 2MW, NË ZONËN SHEQ  
MARINAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE  
TOPOJË, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 10, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”,

të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 19, pika 1, germa “a”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 718, datë 12.10.2016, nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 27.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut në lidhje me “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrale fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2mw, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier,

konstatoi se:

Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 213 prot., datë 12.3.2019, ka paraqitur aplikimin, për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaike me fuqi të instaluar 2 mw.

Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k. në cilësinë e mbajtësit të miratimit ka lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, kontratën me nr. 6380 rep. dhe nr. 2756 kol., datë 31.12.2018 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaike “Smart Watt” sh.p.k. me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Topojë, qarku Fier.

Aplikimi i shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;



- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”, pika 4.1.5, germa “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga prokuroria, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Tiranë), germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit në përputhje me aktivitetin), germa “g” (saktësimi mbi dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (në kontratën e qirasë nr. 968 rep. dhe nr. 275 kol., datë 24.5.2018, është konstatuar mungesa e faqes së fundit me nënshkrimet përkatëse).

- Dokumentacioni teknik, për centralet solare: pika 4.4.1. (të dhëna specifike për Centralin Solar të plotësuar nga aplikuesi), pika 4.4.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin të plotësuar nga aplikuesi), pika 4.4.4: dokumentacioni tekniko- ekonomik, germa “a” (Studimi i fizibilitetit), germa “b” (Grafiku i zbatimit të projektit), germa “c” (Oponenca teknike e projektit), germa “d” (Plani i biznesit). Pika 4.5 plotësimin e lejeve të munguara nga institucione të tjera, germa “a”, miratimin e OST-së ose OSHE-së, për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes. OSHEE sh.a. në shkresën nr. 26578/1, datë 14.9.2018 ka rekomanduar marrjen e miratimit për pikën e lidhjes nga OST sh.a.

- Subjekti në formatin e aplikimit ka paraqitur të dhënat si vijon: centrali prodhues 2 mw - “Smart Watt” sh.p.k., tipi i centralit solar, tipi i panelave Polikristalin, sipërfaqja e paneleve 30.000 m<sup>2</sup>, orët e punës në një vit 2.010 h/vit, fuqia e instaluar 2 mw, numri i njësive gjeneruese dhe fuqia e instaluar 312x0,0064 mw=2 mw, niveli i tensionit kV=35kV, N/st ku lidhet centrali linja 35/10kV, hoxharë, tensioni i rrjetit të shpërndarjes /transmetimi ku lidhet centrali 35 kV. Prodhimi vjetor i energjisë  $E_{vjet} = 31.36 \text{ mwh}$ , rendimenti 15.5%, viti i ndërtimit 2019, data e fillimit të operimit 2019, jetëgjatësia e centralit 25 vjet. Sa u përket këtyre të dhënave, do t'i kërkohej subjektit sqarimet përkatëse duke qenë se bien ndesh me ato të pasqyruara në studimin e fizibilitetit dhe me kontratën e nënshkruar me MIE-n.

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t'i paraqesë ato në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me fuqi të instaluar 2 mw, të ndodhur në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut do të njoftojë subjektin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM,  
ANËTARE E BORDIT  
Erjola Sadushi

#### VENDIM Nr. 7, datë 8.2.2019

#### PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBITIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit



mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 8.2.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësllës - Kanalizime Gjirokastër sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

#### VËREN SE:

1. Shoqëria “Ujësllës-Kanalizime Gjirokastër” (UK Gjirokastër), me shkresën nr. 983 prot., datë 20.7.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse mirëmbajtje rrjeti të ujësllësit” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të

Ujërave të Ndotura (ERRU) për rritjen e tarifave në zonën urbane të shërbimit dhe caktimin e tarifës fikse për zonën rurale të shërbimit, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarife fikse të shoqërisë UK Gjirokastër në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendim nr. 59, datë 20.7.2018 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Gjirokastër për nivelin e ri tarifar për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

3. UK Gjirokastër, nëpërmjet shkresës nr. 983 prot., datë 20.7.2018, me lëndë “Kërkesë për vendosjen e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse mirëmbajtje rrjeti të ujësllësit”, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-s-së për rritje të tarifave në zonën urbane të shërbimit dhe aplikimin e tarifës fikse për zonën rurale, sipas tabelës:

| Kategoritë e klientëve                             | Tarifat aktuale           |                                                 | Tarifat e propozuara      |                                                 |
|----------------------------------------------------|---------------------------|-------------------------------------------------|---------------------------|-------------------------------------------------|
|                                                    | Zona urbane               | Zona rurale                                     | Zona urbane               | Zona rurale                                     |
|                                                    | Gjirokastër               | Cepo, Picar, Lazarat, Lunxhëri, Antigone, Odrie | Gjirokastër               | Cepo, Picar, Lazarat, Lunxhëri, Antigone, Odrie |
| <b>A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë</b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b>                       | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b>                       |
| 1. Klientë familjarë                               | 43                        | 25                                              | 46                        | 25                                              |
| 2. Klientë publikë                                 | 125                       | 60                                              | 133                       | 60                                              |
| 3. Klientë privatë                                 | 130                       | 60                                              | 138                       | 60                                              |
| <b>B. Tarifë volumetrike për KUN-in</b>            | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b>                       | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b>                       |
| 1. Klientë familjarë                               | 10                        | -                                               | 11                        | -                                               |
| 2. Klientë publikë                                 | 16                        | -                                               | 18                        | -                                               |
| 3. Klientë privatë                                 | 16                        | -                                               | 18                        | -                                               |
| <b>C. Tarifë fikse</b>                             | <b>Lekë/muaj/lidhje</b>   | <b>Lekë/muaj/lidhje</b>                         | <b>Lekë/muaj/lidhje</b>   | <b>Lekë/muaj/lidhje</b>                         |
| 1. Klientë familjarë                               | 80                        | -                                               | 150                       | 80                                              |
| 2. Klientë publikë                                 | 80                        | -                                               | 200                       | -                                               |
| 3. Klientë privatë                                 | 80                        | -                                               | 200                       | -                                               |



4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se treguesit e arritur të performancës për vitin 2017 dhe objektivat e propozuar nga shoqëria UK Gjirokastrë për vitin 2019 janë sipas tabelës së mëposhtme:

| Treguesit e performancës | Njësia           | Treguesit e performancës Viti 2017 | Objektivat e propozuar nga shoqëria Viti 2019 |
|--------------------------|------------------|------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Uji pa të ardhura        | %                | 44.7                               | 49.3                                          |
| Mbulimi i kostove O&M    | %                | 108                                | 117.5                                         |
| Mbulimi i kostove totale | %                | 92.4                               | 100                                           |
| Niveli i matjes          | %                | 33.9                               | 68.4                                          |
| Vazhdimësia e FU-së      | orë/ditë         | 13                                 | 13                                            |
| Efikasiteti i stafit     | Staf/1000 lidhje | 9.96                               | 10.52                                         |
| Mbulimi me ujë           | %                | 100                                | 100                                           |
| Mbulimi me KUN           | %                | 40                                 | 40                                            |
| Norma e arkëtimit        | %                | 82                                 | 87.7                                          |

a) Uji pa të ardhura për UK Gjirokastrë për vitin e kaluar është 44.7 %. Humbjet vjetore janë 1,469,478 m<sup>3</sup>/vit, nga të cilat 24% janë **humbje administrative** dhe 76% janë **humbje teknike**. Humbjet administrative shkaktohen kryesisht nga administrimi jo i mirë i të dhënave, vlerësimi joreal i volumeve të prodhuara e të faturuara si rezultat i mungesës së matësve në pikat e prodhimit dhe në një pjesë të mirë të konsumatorëve. Humbjet teknike shkaktohen nga rrjedhjet në linjat e transmetimit shpërndarjes dhe në depot e ujit. Ky indikator do të ketë një përkeqësim për vitin 2019 në 49%, për arsye se sasia e ujit të faturuar do të bjerë nga pajisja e konsumatorëve me matës.

b) Për vitin 2019, UK Gjirokastrë ka parashikuar kosto operative dhe mirëmbajtje (O&M) rreth 6.4 milionë lekë më të larta krahasuar me vitin 2018, ndërsa të ardhurat janë parashikuar të rriten me rreth 13.6 milionë lekë. Ky parashikim i të ardhurave dhe i shpenzimeve do të sjellë rritje të nivelit të mbulimit të kostove O&M nga 108% në vitin 2017, në 111.6% për vitin 2018 (i pritshmi) dhe në nivelin 117.5% për vitin 2019 (parashikimi).

c) Niveli i matjes për vitin 2017 paraqitet në nivelin 34%. Krahas vënies në shfrytëzim të ujësjellësit të ri, nga i cili ka përfituar një pjesë e konsiderueshme e qytetit, instalimi i ujëmatësve ka sjellë dhe zgjatje të orëve të shërbimit dhe nga ana tjetër faturimin e asaj që realisht konsumatori

konsumon. Shoqëria ka parashikuar të instalojë rreth 2,750 matës në vitin 2019, kështu do të arrijë një nivel matje 68.4 % dhe nuk do të ketë asnjë konsumator jofamiljarë pa matës në zonën urbane. ERRU-ja e orienton shoqërinë drejt përmirësimit të këtij treguesi duke shfrytëzuar një pjesë të të ardhurave të shoqërisë, që pas mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes të përdoren për blerjen dhe instalimin e 1700 matësve, që do ta çojë këtë tregues në nivelin 78% në mbyllje të vitit 2019.

d) Kohëzgjatja mesatare e orëve të furnizimit është 13 orë në ditë. Investimet në zonën e qytetit kanë realizuar furnizimin me ujë 24/7, megjithatë në disa nën zona konsumatorët furnizohen me orar të reduktuar 3-4 orë/ditë, ndërsa në zonat rurale ka orare të ndryshme furnizimi por mesatarisht furnizohen me 5-6 orë/ditë. Për vitin 2019 shoqëria parashikon të njëjtën nivel shërbimi pa ndonjë ndryshim pozitiv të këtij treguesi.

e) Norma e arkëtimit të përgjithshëm është rreth 82% dhe parashikohet që për vitin 2019 të arrijë normën e arkëtimit në masën 87.7%. Edhe pse në nivele të performancës së mirë shoqëria sqaron se në zonën rurale niveli i mbledhjes së të ardhurave është i ulët, nga 60% deri 65%, dhe i tillë është parashikuar edhe për vitin e ardhshëm 2019.

f) Sh.a. UK Gjirokastrë raporton një popullsi totale në zonën e juridiksionit prej 52,300 banorë, ku rreth 82% e tyre i takon zonës urbane dhe



vetëm 18% zonës rurale që dikur shërbehej nga ish- Ujësjellësi Gjirokastër Fshat. Si shoqëri e riorganizuar shërbimi me ujë të pijshëm i ofrohet 100% të popullsisë totale të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile.

g) Për tri vitet 2017-2018-2019 shoqëria raporton të njëjtin nivel të mbulimit me shërbimin e kanalizimeve rreth 40,7%. Për sa u përket studimeve në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të shkarkimit të ujërave të ndotura aktualisht pjesë e projektit të financuar nga Fondi Amerikan i Zhvillimit është zona e pazarit ndërsa për pjesën tjetër do të pritët fillimi i fazës tjetër të projektit MIP III&IV.

h) Treguesi staf për 1000 lidhje UK nga 9.96 në vitin 2017, në mbyllje të vitit 2018 është parashikuar të jetë 10.52 punonjës/1000 lidhje UK, për shkak të rritjes së stafit me 10 punonjës të rinj. Edhe për vitin e ardhshëm 2019 mbetet i njëjti nivel i këtij treguesi, sepse numri i stafit nuk ndryshon, ndërsa rritja e numrit të lidhjeve UK është e papërfillshme në ndikimin që jep në këtë tregues.

5. Nevoja e ndryshimit të tarifave nga ana e UK Gjirokastër argumentohet me:

a) Pas zgjerimit të zonës së shërbimit shoqëria aplikon për herë të parë sipas metodologjisë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, bazuar në analizën e gjendjes teknike dhe ekonomike të saj, konkretisht analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara, analizën dhe përcaktimin e objektivave për treguesit e performancës.

b) Nevojën për përmirësimin e treguesve të performancës në aspektin ekonomik dhe në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit

c) Tarifat e propozuara do të sigurojnë të ardhura të domosdoshme për përmirësimin e performancës financiare, me qëllim garantimin e shlyerjes së kredisë së përfutur nga projektet e KfW-së.

d) Nevoja për arritjen e nivelit 100% të mbulimit të kostove totale.

6. ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ka kërkuar nga UK Gjirokastër informacion shtesë si

dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

7. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Gjirokastër, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregut;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) mbulimit të kostove totale, pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që mund të arrijnë të mbulojnë këto kosto dhe të sigurojnë qëndrueshmëri financiare;

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifat duhet të jenë të përballueshme;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

g) nivelin tarifor të propozuar nga shoqëria ERRU e gjen të justifikuar për sa u përket tarifave volumetrike për dy shërbimet ujë dhe kanalizime;

h) rritjen e nivelit të tarifës fikse të propozuar nga operatori, ERRU-ja e gjen të pajustificuar, pasi tarifat e miratuara në nivelin sipas germës “g” të mësipërme, si dhe realizimi i objektivave mbi treguesit e performancës të vendosur nga ERRU-ja për vitin 2019, përmbushin nevojat e qëndrueshmërisë financiare të operatorit.

8. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

- Shoqëria ka një plan biznesi (2017–2021), por që nuk është i përditësuar me ndryshimet e ndodhura në kuadër të riorganizimit të shoqërisë



sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016. Detyrimisht brenda vitit 2019, shoqëria duhet të hartojë planin e biznesit, i cili t'u përgjigjet nevojave reale dhe në përputhje me formatin e AKUM-it.

- Të pajiset me matës të mëdhenj në të gjitha pikat e prodhimit të ujit, në rezervuarë dhe sidomos në konsumatorë pasi niveli i sasisë së ujit që humbet nga pasaktësia në matje në konsumator i kalon vlerat e lejuara.

- Të hartohet bilanci i ujit sa më real, për të gjithë nënçerërat e tij, duke mbajtur evidenca mbi sasinë ditore të ujit që prodhohet, mbi defektet e ndodhura gjatë vitit në sistemin e furnizimit, si dhe të përllëgaritet sasia e humbur e ujit para riparimit dhe gjatë riparimit për secilin defekt të ndodhur.

- Të saktësojë në bilancin e ujit pasaktësitë në matje te konsumatorë (jo më shumë se 5%). si dhe nënfaturimi për konsumatorët me dhe pa matje nga gabimi njerëzor, abuzimi i faturuesve, si dhe abuzimet në ujitje, sidomo në zonat rurale.

- Të rritet niveli i matjes, duke shfrytëzuar edhe rritjen e mbulimit të kostove të amortizimit. Niveli i matjes të jetë 100% për zonën urbane dhe të bëhen përpjekje për instalimin e matësve edhe për zonën rurale.

-Shoqëria duhet të mbajë në kontabilitet të ndara me qendra kostojë shërbimet që ofron ujë dhe kanalizime, me qëllim që dhe tarifat të orientohen drejt kostove.

-Shoqëria duhet të evidentojë klientët problematikë, si dhe hartojë një plan masash të

detajuar për vjeljen e debive të prapambetura, gjithashtu, duhet të ndjekë hapat ligjorë për debitorët pa shpresë kthimi.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e metodologjisë, të miratuar me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatimim të kriterëve ligjorë referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuar, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar

#### VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë, si më poshtë:

| Kategoritë e klientëve                             | Zona urbane<br>Gjirokastrë | Zona rurale<br>Cepo, Picar, Lazarat,<br>Lunxhëri, Antigone,<br>Odrë |
|----------------------------------------------------|----------------------------|---------------------------------------------------------------------|
| <b>A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë</b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b>  | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b>                                           |
| 1. Klientë familjarë                               | 46                         | 25                                                                  |
| 2. Klientë publikë                                 | 133                        | 60                                                                  |
| 3. Klientë privatë                                 | 138                        | 60                                                                  |
| <b>B. Tarifë volumetrike për KUN-in</b>            | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b>  | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b>                                           |
| 1. Klientë familjarë                               | 11                         | -                                                                   |
| 2. Klientë publikë                                 | 18                         | -                                                                   |
| 3. Klientë privatë                                 | 18                         | -                                                                   |
| <b>C. Tarifë fikse</b>                             | <b>Lekë/muaj/lidhje</b>    | <b>Lekë/muaj/lidhje</b>                                             |
| 1. Klientë familjarë                               | 100                        | 80                                                                  |
| 2. Klientë publikë                                 | 100                        | -                                                                   |
| 3. Klientë privatë                                 | 100                        | -                                                                   |



2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2019 për shoqërinë UK Gjirokastrë të jenë:

| Treguesit kryesorë të performancës | Njësia e matjes      | Niveli i objektivit të përcaktuar nga ERRU-ja |
|------------------------------------|----------------------|-----------------------------------------------|
| Mbulimi i kostove O&M              | %                    | 110                                           |
| Mbulimi i kostove totale           | %                    | 94                                            |
| Uji pa të ardhura                  | %                    | 49.3                                          |
| Mbulimi me ujë                     | %                    | 100                                           |
| Mbulimi me KUN-in                  | %                    | 40                                            |
| Niveli i matjes                    | %                    | 78                                            |
| Norma e arkëtimit                  | %                    | 87.7                                          |
| Vazhdimësia e furnizimit me ujë    | orë/ditë             | 13                                            |
| Eficienca e stafit                 | staf/1000/ lidhje UK | 10.52                                         |

3. Paga rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësllës-Kanalizime Gjirokastrë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Gjirokastrë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimi nr. 12, datë 30.3.2017 “Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Gjirokastrë Qytet sh.a.”, vendimi nr. 31, datë 12.7.2010 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. U Gjirokastrë (fshat)” dhe vendimi nr. 45, datë 26.12.2011 “Për miratimin e tarifës së shitjes së ujit me shumicë (Komunës Dropull i Poshtëm) për Sh.a. U Gjirokastrë Fshat”, shfuqizohen.

6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.4.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Ndrëçim Shani

## VENDIM Nr. 8, datë 8.2.2019

### PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS - KANALIZIME POLIÇAN SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe



largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 8.2.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetës-Kanalizime Polican sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

#### VËREN SE:

1. Shoqëria “Ujësjetës-Kanalizime Polican” (UK Polican), me shkresën nr. 389, datë 28.6.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, për të tri kategoritë e konsumatorëve, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse të shoqërisë UK Polican, në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 59, datë 20.7.2018 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Polican për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

3. UK Polican, nëpërmjet shkresës nr. 389 prot., datë 28.6.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, për të tri kategoritë e konsumatorëve të paraqitur në tabelën më poshtë.

**Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve**

| Kategoritë e konsumatorëve                         | Tarifat aktuale           |                           | Tarifat e propozuara      |
|----------------------------------------------------|---------------------------|---------------------------|---------------------------|
|                                                    | NJA Polican               | NJA Vërtop                | Zona e shërbimit          |
| <b>A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë</b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b> |
| 1. Konsumatorë familjarë                           | 37                        | 44                        | 50                        |
| 2. Konsumatorë publikë                             | 80                        | 125                       | 125                       |
| 3. Konsumatorë privatë                             | 95                        | 125                       | 125                       |
| 4. Uji me shumicë UK Berat Kuçovë                  | -                         | -                         | 23.9                      |
| 5. Uji me shumicë UK Skrapar                       | -                         | -                         | 21.41                     |
| <b>B. Tarifë volumetrike për KUN-in</b>            | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b> | <b>Lekë/m<sup>3</sup></b> |
| 1. Konsumatorë familjarë                           | 9                         | 9                         | 12.5                      |
| 2. Konsumatorë publikë                             | 9                         | 9                         | 20                        |
| 3. Konsumatorë privatë                             | 9                         | 9                         | 20                        |
| <b>C. Tarifë fikse</b>                             | <b>Lekë/muaj/lidhje</b>   | <b>Lekë/muaj/lidhje</b>   | <b>Lekë/muaj/lidhje</b>   |
| 1. Konsumatorë familjarë                           | -                         | 100                       | 100                       |
| 2. Konsumatorë publikë                             | -                         | 200                       | 200                       |
| 3. Konsumatorë privatë                             | -                         | 200                       | 200                       |
| 4. Uji me shumicë                                  | -                         | -                         | 1000                      |



4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se treguesit e arritur të performancës për vitin 2017 dhe objektivat e propozuar nga shoqëria UK Poliçan për vitin 2019, janë sipas tabelës së mëposhtme:

| Treguesit e performancës | Njësia           | Treguesit e performancës Viti 2017 | Objektivat e propozuar nga shoqëria Viti 2019 |
|--------------------------|------------------|------------------------------------|-----------------------------------------------|
| Uji pa të ardhura        | %                | 60                                 | 32.6                                          |
| Mbulimi i kostove O&M    | %                | 46.6                               | 99.3                                          |
| Mbulimi i kostove totale | %                | 44.6                               | 90.8                                          |
| Niveli i matjes          | %                | 63.4                               | 90.5                                          |
| Vazhdimësia e FU-së      | orë/ditë         | 16                                 | 24                                            |
| Efikasiteti i stafit     | Staf/1000 lidhje | 14.5                               | 6.7                                           |
| Mbulimi me ujë           | %                | 63.5                               | 71.8                                          |
| Mbulimi me KUN           | %                | -                                  | 69.5                                          |
| Norma e arkëtimit        | %                | 78.8                               | 88.4                                          |

a) Treguesi “Uji pa të ardhura”, për vitin 2017, është në nivelin 60%. Sasia e ujit të prodhuar është 715, 525 m<sup>3</sup> ujë. Humbjet administrative janë 51% e humbjeve totale, ndërsa ato reale 49% e tyre. Për vitin 2018, shoqëria parashikon që niveli i UPA-së të pësojë një rënie të lehtë (58, 3%).

Për vitin 2019, shoqëria parashikon që niveli i humbjeve të jetë 32.6%. Ky ndryshim kaq i madh është i pritshëm, sepse shoqëria ka parashikuar të shesë ujë me shumicë rreth 300 mijë m<sup>3</sup> shoqërive UK Skrapar dhe UK Berat Kuçovë.

b) Nevoja për të ardhura, për vitin 2019, synon përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove O&M nga rreth 47% për vitin 2017 në 99.3%. Mbulimi i kostove O&M në këtë nivel do të përbënte një kërcim mjaft të madh të vlerës së faturës për konsumatorët familjarë, me rrezikun e pasojave negative nga një reaksion në masë për mospagim të faturës së ujit nga ana e tyre.

c) Si për vitin e mbyllur 2017, por edhe aktualisht për vitin 2018, shoqëria raporton të njëjtin nivel matjeje rreth 63.4%. Për vitin 2019, shoqëria ka parashikuar të instalojë 1000 matës për klientët familjarë që do të përmirësojnë këtë tregues në nivelin 90%. Ky është një objektiv ambicioz i shoqërisë, që përkon dhe me nismat e qeverisë në kuadër të reformës së ujit, ndërkohë që nuk do të lejohet asnjë klient jofamiljar pa matës. Nga ana tjetër, bashkia planifikon të instalojë edhe 100 matës familjarë në NJA Vërtop dhe Terpan. Faturimi aforfe do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2019 për rreth 300 klientë familjarë.

d) Aktualisht, vazhdimësia e furnizimit me ujë është mesatarisht 16 orë në ditë në zonën urbane të Bashkisë Poliçan, kurse NJA Vërtop furnizohet 24 orë çdo ditë të javës.

Objektivi i shoqërisë është që deri në fund të vitit 2019 si rezultat i investimeve në proces dhe atyre të pritshme e gjithë zona e shërbyer nga UK Poliçan ka si objektiv të furnizohet 24 orë në ditë.

e) Treguesi “Norma e arkëtimit” për vitet 2017-2018 është 78%, ndërsa për vitin 2019 parashikohet në nivelin 88%. Shoqëria është angazhuar në sensibilizimin e konsumatorëve për shlyerjen e detyrimit në kohë, si dhe në kontrollin e vazhdueshëm mbi konsumatorët debitorë.

f) Sh.a. UK Poliçan raporton popullsinë totale në zonën e juridiksionit 17,271 banorë, ku treguesi mbulimi me ujë nga 63.5% në vitin 2017, synon të shkojë në 71.8% në vitin 2019, duke marrë në konsideratë investimet e parashikuara nga Bashkia Poliçan.

g) Shoqëria, vetëm më 2018-n, ka filluar të ofrojë shërbimet e KUN Poliçanit dhe një pjesë të konsiderueshme të NJA Vërtop. Kjo përkon me 67,2% të popullsisë në juridiksion. Për vitin 2019, ky shërbim parashikohet të jetë në nivelin 69,5%.

h) Në vitin 2017, shoqëria e kryente aktivitetin e saj me 42 punonjës, pra me një tregues efikasiteti stafi 14.5 punonjës për 1000 lidhje ujësjellësi. Niveli i lartë i këtij treguesi justifikohet pasi shoqëria deri në vitin 2017 ka ofruar vetëm shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, ndërkohë që referenca e këtij treguesi duhet të përfshijë dhe



lidhjet e KUN-it. Ky tregues rritet, gjithashtu, artificialisht, sepse shërbimin e rojeve shoqëria e kryen jo me të tretë, por me punonjësit e saj.

Në vitin 2018 shoqërisë i transferohen nga Bashkia Polican shërbimet e KUN-it, të cilat rritin me 6 punonjës të tjerë stafin e saj. Marrja e këtyre shërbimeve influencon në përmirësimin e këtij treguesi, gjithashtu, artificialisht në 8.13 punonjës për 1000 lidhje UK. Gjithsesi shoqëria planifikon që në vitin 2019 të reduktojë me 4 punonjës stafin operues, pra gjithsej do të zhvillojë aktivitetin me 44 punonjës. Efekti i uljes së numrit të stafit dhe njëkohësisht rritja e numrit të lidhjeve edhe pse në nivele të ulëta krahasuar me vitin aktual 2018 do të sjellë përmirësim të këtij treguesi, i cili, në mbyllje të vitit 2019, parashikohet të jetë 6.7 punonjës për 1000 lidhje UK.

5. Nevoja e ndryshimit të tarifave nga ana e UK Polican argumentohet:

a) Pas zgjerimit të zonës së shërbimit Shoqëria aplikon për herë të parë sipas metodologjisë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, bazuar në analizën e gjendjes teknike dhe ekonomike të saj, konkretisht analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara, analizën dhe përcaktimin e objektivave për treguesit e performancës.

b) Nevojën për përmirësimin e treguesve të performancës në aspektin ekonomik dhe në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit.

c) Nevojën e përmirësimit të performancës financiare, ku kostot e shërbimeve UK nuk mbulohen as 50% me të ardhurat e faturuara për këto shërbime. Shoqëria krahas përpjekjeve për mirë menaxhim në drejtim të mbajtjes nën kontroll të kostove, si dhe rritjes së eficiencës së mbledhjes së të ardhurave e ka të domosdoshme ndryshimin e tarifave me qëllim gjenerimin e të ardhurave shtesë për përballimin e kostove të domosdoshme dhe të justifikuar.

d) Shoqëria ende ka nevojë për subvencione nga qeveria për shlyerjen e faturave të energjisë elektrike, si dhe të detyrimeve të tjera të prapambetura, por dhe të përballimit të kostove të tjera të vitit.

6) ERRU, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike, sipas metodologjisë së llogaritjes së

tarifave të përcaktuar në vendimin nr.42, ka kërkuar nga UK Polican informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

7. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Polican të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) Orientimit drejt mbulimit të kostove O&M pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që nuk i mbulojnë këto kosto.

e) Tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifatat duhet të jenë të përballueshme.

f) Tarifatat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

g) Në përcaktimin e nivelit tarifor për dy shërbimet UK, si dhe për shitjen e ujit me shumicë për dy shoqëritë UK Skrapar dhe UK Berat Kuçovë, ERRU-ja ka llogaritur nevojën për të ardhura të shoqërisë duke marrë në konsideratë përmirësimin e treguesit mbulimi i kostove O&M në nivel të tillë që dhe tarifatat të mos pësojnë kapërcim me efekt të ndjeshëm të konsumatorët, por nga ana tjetër të përmbushen gradualisht nevojat e shoqërisë për një përmirësim gradual të qëndrueshmërisë financiare duke siguruar dhe realizimin e objektivave mbi treguesit e performancës të vendosur nga ERRU-ja për vitin 2019.

Nisur nga sa më sipër ERRU-ja për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm:

- e gjen të justifikuar propozimin e shoqërisë si



për tarifën volumetrike ashtu dhe për tarifën fikse për konsumatorët familjarë;

- e gjen të pajustificuar propozimin për tarifën fikse dhe atë volumetrike për konsumatorët privat dhe institucione;

- e gjen të pajustificuar tarifën volumetrike të shitjes së ujit me shumicë për shkak të pasaktësive në llogaritje dhe tarifën fikse të shërbimit për dy blerësit UK Skrapar dhe UK Berat Kuçovë.

#### **Për shërbimin e kanalizimeve**

- ERRU-ja e gjen të pajustificuar propozimin e shoqërisë për tarifat volumetrike për të tre kategoritë e klientëve për largimin e ujërave të ndotura.

8. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

- Shoqëria duhet të hartojë një plan biznesi 5-vjeçar sipas standardit të AKUM-it i cili duhet të jetë i disponueshëm në propozimin pasardhës për ndryshimin e tarifave.

- Shoqëria duhet të evidentojë klientët problematike, të hartojë një plan masash të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura dhe në përputhje me kërkesat e reformës së ujit.

- Shoqëria duhet të hartojë planin për menaxhimin e “shpenzimeve të tjera” duke zvogëluar kostot nga kamatëvonesat për shkak të paafësisë paguese në kohë të faturave të energjisë elektrike dhe penalitetet për detyrimet tatimore.

- Shoqëria duhet të evidentojë gjendjen e aseteve të ndara për ujin dhe kanalizimet, amortizimin e tyre, si dhe grupimin sipas moshës së aseteve me qëllim marrjen e masave për rinovimin e tyre kjo në funksion edhe të të ardhurave të shoqërisë.

- Shoqëria duhet të negociojë e të koordinojë me AKUM-in me qëllim përfitimin e subvencioneve në kohën dhe vlerën e nevojshme me qëllim reduktimin e kostove të panevojshme si gjoba e kamatë vonesa.

- Peshën më të lartë të shpenzimeve ndaj totalit të kostove për të tri vitet e zënë shpenzimet për personelin me rreth 59% për vitin 2019. Shoqëria duhet të hartojë një organigramë më efektive dhe me përshkrime të detajuara të punës dhe të justifikuar për çdo pozicion me qëllim uljen e kostove të punës dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të saj.

- Shoqëria duhet të mbajë në kontabilitet të ndara me qendra kostoje shërbimet që ofron ujë dhe kanalizime me qëllim që dhe tarifat të orientohen drejt kostove.

- Shoqëria duhet të pajisë me matës burimin pasi niveli i sasisë së ujit që konsiderohet si humbje nga pasaktësia në matje në prodhim është i papranueshëm. Reduktimi i humbjeve administrative është një emergjencë për sh.a. UK Poliçan. Gjatë periudhës që shoqëria nuk ka të instaluar matës në prodhim, duhet të mbajë regjistra ku të pasqyrohet sasia ditore e ujit që prodhohet bazuar në orët e punës të secilës pompë në stacionin e pompimit.

- Për të hartuar bilancin e ujit sa më real, duhet të tregojë kujdes në mbledhjen e të dhënave për të plotësuar sa më saktë të gjithë nën zërat. Kryesisht duhet të bëhen përpjekje për vlerësimin e humbjeve që vijnë nga nën faturimi i klientëve pa matje si nga mbi përdorimi i ujit nga ana e tyre, por edhe nga raportimet e numrit të banorëve për familje më të vogël sesa është realisht.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatimim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuar, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Poliçan, si më poshtë:



| Kategoria                      | Tarifat sipas vendimit<br>Zona e shërbimit  |                                  |                  |
|--------------------------------|---------------------------------------------|----------------------------------|------------------|
|                                | Tarifë volumetrike<br>për furnizimin me ujë | Tarifë volumetrike<br>për KUN-in | Tarifë fikse     |
|                                | Lekë/m <sup>3</sup>                         | Lekë/m <sup>3</sup>              | Lekë/muaj/lidhje |
| Konsumatorë familjarë          | 50                                          | 12                               | 100              |
| Konsumatorë publikë            | 100                                         | 15                               | 100              |
| Konsumatorë privatë            | 110                                         | 15                               | 100              |
| Uji me shumicë UK Berat Kuçovë | 4                                           | -                                | -                |
| Uji me shumicë UK Skrapar      | 6                                           | -                                | -                |

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2019 për shoqërinë UK Poliçan të jenë:

| Treguesit e Performancës | Njësia           | Niveli i objektivit të përcaktuar nga<br>ERRU-ja |
|--------------------------|------------------|--------------------------------------------------|
| Uji pa të ardhura        | %                | 32.6                                             |
| Mbulimi i kostove O&M    | %                | 79                                               |
| Mbulimi i kostove totale | %                | 72                                               |
| Niveli i matjes          | %                | 90.5                                             |
| Vazhdimësia e FU-së      | orë/ditë         | 24                                               |
| Efikasiteti i stafit     | staf/1000 lidhje | 6.7                                              |
| Mbulimi me ujë           | %                | 71.8                                             |
| Mbulimi me KUN-in        | %                | 69.5                                             |
| Norma e arkëtimit        | %                | 88.4                                             |

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Poliçan sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Poliçan brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimit nr. 13, datë 31.3.2015 për UK Poliçan si dhe vendimi nr. 10, datë 21.5.2014 për NJA Vërtop (ish-pjesë e UK Berat Kuçovë), shfuqizohen.

6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.4.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Ndriçim Shani**

## VENDIM

**Nr. 11, datë 27.2.2019**

### PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME PUKË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),



Komisioni Kombëtar Rregullator,  
në mbledhjen e datës 27.2.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Sektori Juridik mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Pukë Sh.a për licencim,

#### VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Pukë (UK Pukë), me shkresën nr. 22 prot., datë 16.1.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të zonës së shërbimit dhe ndryshimit të drejtuesit teknik.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të zonës së shërbimit dhe ndryshimit të drejtuesit teknik të UK Pukë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) UK Pukë ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar për shkak të riorganizimit të shoqërisë sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63;

b) Shoqëria UK Pukë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 15 715 banorë në Bashkinë Pukë;

c) Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Pukë sh.a. plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ndryshimit të zonës së shërbimit dhe ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Pukë, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur

funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjetllësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, veçanërisht, në lidhje me organizimin e njërive të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve si shoqëri aksionare sipas sistemit me një nivel administrimi.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Pukë, rekomandon:

- Shoqëria UK Pukë duhet të aplikojë pranë ERRU-së për rishikimin e nivelit tarifor pas riorganizimit të shoqërisë sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Pukë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Pukë sh.a. me NUIS J69310307F, në kategoritë:

a) Kategoria A - për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Pukë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor - Petrit Dedaj;

b) Drejtues teknik - Hydajet Kuçi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Pukë sh.a. është Bashkia Pukë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.



5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Pukë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Pukë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Ndriçim Shani

**VENDIM**  
**Nr. 125, datë 4.4.2019**

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË  
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË  
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS  
SHUMEMËRORE TË PARTISË  
DEMOKRATIKE, QARKU TIRANË, PËR  
PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË  
NJOFTUAR NGA KUVENDI I  
SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 4.4.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri kryetar;  
Denar Biba zv.kryetar;  
Bledar Skënderi anëtar;  
Edlira Jorgaqi anëtare;  
Rezarta Bitri anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit, znj. Orjola Hysni Pampuri.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 792/1 prot., datë 25.2.2019, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë, për shkak të përfundimit të parakohshëm të mandateve të deputetëve të zonës zgjedhore të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Tiranë.

Neni 164, i Kodit Zgjedhor, përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore, të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike, për zonën zgjedhore qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017, ka fituar 11 (njëmbëdhjetë) mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, janë numri rendor 1 (një) z. Lulzim Xhelal Basha, me numër rendor 2 (dy) znj. Orjola Hysni Pampuri, me numër rendor 3 (tre) znj. Rudina Azem Hajdari, me numër rendor 4 (katër) znj. Grida Agim Shqina (Duma), me numër rendor 5 (pesë) znj. Albana Sadik Vokshi, me numër rendor 6 (gjashtë) znj. Jorida Hasan Tabaku, me numër rendor 7 (shtatë) z. Sali Ram Berisha, me numër rendor 8 (tetë) z. Halim Marsut Kosova, me numër rendor 9 (nëntë) z. Gent Hysen Strazimiri, me numër rendor 10 (dhjetë) z. Fatmir Ali Mediu, me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) z. Dashamir Hamit Shehu.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Demokratike, qarku Tiranë, nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë, duke mos pasur tridhjetë për qind të listës shumëmemërore nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 566, datë 5.10.2017, vendosi



sanksionin administrativ gjorbë në masën 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë ndaj Partisë Demokratike.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja, në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e Partisë Demokratike, në zonën zgjedhore qarku Tiranë, duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave, për shkak të heqjes dorë nga mandatet e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë të subjektit politik Partia Demokratike, qarku Tiranë, i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 22 (njëzet e dy), 23 (njëzet e tre), 24 (njëzet e katër), 31 (tridhjetë e një), 37 (tridhjetë e shtatë), 39 (tridhjetë e nëntë), 42 (dyzet e dy), 47 (dyzet e shtatë), 49 (dyzet e nëntë), 12 (dymbëdhjetë), dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 54, 55, 56, 57, datë 12.3.2019, vendimi 70, datë 20.3.2019 si dhe vendimet nr. 101, 103, 104, 105, datë 27.3.2019 ka vendosur, të shpall moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatëve të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, si rezultat i mos dorëzimit të formularit të vetdeklarimit brenda afatit ligjor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 45, datë 11.3.2019 ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit znj. Majlinda Skënder Halilaj, për zëvendësimin e vakancës së krijuar nga z. Lulzim Xhelal Basha.

Në bazë të nenit 175, pika 2, të Kodit Zgjedhor kandidatët vijues nga gjinia më pak e përfaqësuar e listës shumemërore e Partisë Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, qarku Tiranë, kanë shteruar. Në bazë të nenit 164 pika 2 e Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i ka kërkuar kandidatëve vijues të listës shumemërore me numër rendor 13 (trembëdhjetë), 14 (katërbëdhjetë), 15 (pesëmbëdhjetë), 16 (gjashtëmbëdhjetë), 17 (shtatëmbëdhjetë), 18 (tetëmbëdhjetë), 19 (nëntëmbëdhjetë), 20 (njëzet), 21 (njëzet e një), dorëzimin e formularit të vetdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për

garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Në bazë të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalja e fundit, kandidati vijues të cilit i kalon mandati i deputetit, është edhe kandidati për deputet me numër rendor 21 (njëzet e një), z. Korab Qamil Lita.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin e Shqipërisë, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Me shkresën nr. 1885 prot., datë 28.3.2019, z. Korab Qamil Lita, është njoftuar për dorëzimin e formularit të vetdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Z. Korab Qamil Lita, referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më datë 28.3.2019, formularin e vetdeklarimit me numër unik 2126, duke pranuar propozimin e organit për vazhdimin e procedurave për marrjen e mandatit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetdeklarimit, të z. Korab Qamil Lita, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1995 prot., datë 29.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1994 prot., datë 29.3.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Korab Qamil Lita.



KQZ-ja, gjithashtu, ka bërë publikimin e formularit të vëtedeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-947/1 prot., datë 1.4.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, qarku Tiranë, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Korab Qamil Lita, sipas së cilës rezulton se është i padënuar nga gjykatat Shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Korab Qamil Lita, rezulton se, nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidadit të radhës të listës shumemërore e Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 21 (njëzet e një), z. Korab Qamil Lita.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, nenin 164, pika 2, nenin 175, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Tiranë, z. Korab Qamil Lita.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**KRYETARI**  
**Klement Zguri**

#### NJOFTIM

**Nr. 4767, datë 2.4.2019**

#### PËR HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE ME GJERMANINË

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin kulturor dhe miratimin e shtojcës së kësaj marrëveshjeje, nënshkruar më 26.11.2015, ka hyrë në fuqi në datën 25.3.2019.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I  
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE  
PUNËT E JASHTME**  
**Gazmend Barbullushi**

#### KËRKESË

**Nr. 3670/2, datë 29.3.2019**

#### PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike, Lushnjë”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016, i EKB-së Tiranë, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 16, 503 358 (gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI  
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**Artan Shkreli**



**LISTA ME VLERËSIMIN PARAPRAK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, LUSHNJË”**

| Nr | Emër, mbiemër                  | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Rrethi  | Sip. e ndërtimit (m <sup>2</sup> ) | Sip. e truallit (m <sup>2</sup> ) | Çmimi i ndërtimit (l/m <sup>2</sup> ) | Çmimi i truallit (l/m <sup>2</sup> ) | Vlera e ndërtimit (lekë) | Vlera e truallit (lekë) | Vlera Totale (lekë) | Shënime                                                                                                |
|----|--------------------------------|-----------------|----------------|---------|------------------------------------|-----------------------------------|---------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------|-------------------------|---------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    | 1                              | 2               | 3              | 4       | 5                                  | 6                                 | 7                                     | 8                                    | 9                        | 10                      | 11                  | 12                                                                                                     |
| 1  | Xhevdet Korreshi               | ZK. 8571        | 7/104/15       | Lushnjë | —                                  | 283.3                             | —                                     | 9,709                                | —                        | 2,750,559.70            | 2,750,559.70        | Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnjë me shkresën nr. 8424/1prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”. |
| 2  | Bashkëpronarët Lufta           | ZK. 8571        | 7/104/16       | Lushnjë | —                                  | 283.3                             | —                                     | 9,709                                | —                        | 2,750,559.70            | 2,750,559.70        | Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnjë me shkresën nr. 8424/1prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”. |
| 3  | Bashkëpronarët Habili dhe Çela | ZK. 8571        | 7/104/17       | Lushnjë | —                                  | 283.3                             | —                                     | 9,709                                | —                        | 2,750,559.70            | 2,750,559.70        | Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnjë me shkresën nr. 8424/1prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”. |
| 4  | Hekuran Korreshi               | ZK. 8571        | 7/104/18       | Lushnjë | —                                  | 283.3                             | —                                     | 9,709                                | —                        | 2,750,559.70            | 2,750,559.70        | Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnjë me shkresën nr. 8424/1prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”. |
| 5  | Hasan Korreshi                 | ZK. 8571        | 7/104/19       | Lushnjë | —                                  | 283.3                             | —                                     | 9,709                                | —                        | 2,750,559.70            | 2,750,559.70        | Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnjë me shkresën nr. 8424/1prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”. |
| 6  | Petrit Korreshi                | ZK. 8571        | 7/104/20       | Lushnjë | —                                  | 283.3                             | —                                     | 9,709                                | —                        | 2,750,559.70            | 2,750,559.70        | Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnjë me shkresën nr. 8424/1prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”. |

**VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT**

**16,503,358.20**

**KËRKESË**

Shtetasja Lumora Feçi, e datëlindjes 30.11.1949, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Gazmir Ismail Bala.

**KËRKUESE**  
**Lumora Feçi**

**KËRKESË**

Shtetasi Themë Bame, i datëlindjes 27.2.1945, kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të djalit të tij, shtetasit Florenc Themë Bame.

**KËRKUESI**  
**Themë Bame**

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë